



Komunikatë për media

24 Prill, 2020

Prishtinë

CDF mban premtimin!

Fondi për Zhvillim Komunitar - CDF vazhdon përkrahjen e zbatimit të Programit kombëtar për luftimin e pandemisë COVID 19 të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të reagimit ndaj krizës aktuale të pandemisë së COVID -19, në Departamentin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, sot më 24.04.2020 CDF ka dorëzuar:

- Aparaturën për testimin për COVID 19 të njohur si RT PCR,
- Sistemin robotik për përgatitjen e testeve me RT PCR dhe
- Material shpenzues për këto teste.

Ky donacion do të rrisë kapacitetin e Laboratorit molekular të IKSHPK-së, shtimin e numrit të testeve dhe zbulimin e hershëm të sëmundjes si një nga shtyllat kryesore të luftimit të epidemisë me COVID 19. Për më shumë aparatura e dhuruar do të shërbej edhe për testimin dhe zbulimin e hershëm edhe të sëmundjeve tjera ngjitëse.

Vazhdimi i mbështetjes së sistemit shëndetësor u bë përmes Programeve për HIV dhe Tuberkuloz të përkrahura nga Fondi Global dhe të zbatuara nga CDF në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë.

<http://kcdf.org/>

Facebook: @Community Development Fund – CDF

<https://www.instagram.com/communitydevelopmentfund/>